

V E N D I M
Nr.73, datë 17.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPERISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 17.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.99 Akti që i përket:

KËRKUES: HAJDAR KOVAÇI, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore”, përfaqësuar me deklaram nga avokatët Ilir Panda e Mirash Martini.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. GJERGJ KOJA, përfaqësuar me deklaram nga avokat Nikolla Kondakçi.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.28, përfaqësuar nga kryetari Shpëtim Beqiraj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.129, datë 9.7.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.28

BAZA LIGJORE:Nenet 3, 113, 141/I të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin dhe përfaqësuesit e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me kërkesën paraqitur Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi Hajdar Kovaçi pretendon se vendimi nr.129, datë 9.7.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr.17, datë 8.7.2001 i Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.28, është i pavlefshëm, sepse është ushtruar dhunë e janë shkelur haptazi dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Gjatë gjykimit të çështjes, nga administrimi i provave, rezultoi se kërkuesi nuk ka bërë ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kundër vendimit nr.17, datë 8.7.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.28, me të cilin është shpallur deputet zoti Gjergj Koja. Ky fakt tregon se kërkuesi është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese pa konsumuar mjetet e tjera ligjore të ankimit në rrugë administrative, prandaj në bazë të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës dhe neneve 107 e 140 të Kodit Zgjedhor nuk legjitimohet të bëjë ankim në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronjat “e, f” të Kushtetutës, neneve 140 e 141 të Kodit Zgjedhor, si dhe të neneve 26, 67 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.